

### On the linguistic anchoring of the term interpreter in the Albanian language

**Abstract:** *In the Albanian context, from a client and user's perspective, but also on a legal and regulatory plane, interpreting, has not been understood to be a profession which is distinctive from the translation. The perception and conception of the interpreting profession is ingrained in the word 'translator', not merely from a lexico-semantic point of view. In Albanian the noun phrase 'oral translator' is commonly used to differentiate between an interpreter and a translator. Moving beyond that, the collective silent assumption is that anyone who can do translating can also do interpreting bearing consequences for the profession and the service quality. Therefore, the author intends to elaborate on the lexical embedment of the terms interpret (en. interpreter) and interpretim (en. interpreting) in Albanian, as well as their use in the discourse of Albanian Translation and Interpreting Studies scholars. These reflections are intended to make a contribution to promoting the discussion on the autonomous professional identity of the interpreter in the public discourse in Albania and therefore the need for the terminological distinctiveness between the term interpret (en. interpreter) and përkthyes (en. translator).*

**Keywords:** *interpreter, interpreting, translator, translation, Interpreting Studies.*

#### 1. Shënime të përgjithshme dhe objekti i studimit

Në Shqipëri mungon një ndarje e qartë dhe e prerë ndërmjet përkthyesit dhe interpretit si në këndvështrimin shoqëror, ashtu dhe atë ligjor. Interpretimi as nuk trajtohet si një veprimtari e mëvetësishme profesionale, dhe as nuk përkufizohet si e tillë nga pikëpamja ligjore. Ai konsiderohet thjesht si një formë përkthimi. Sikurse shprehet Pöchhacker «...në shumicën e rasteve rregullimet ligjore kufizohen vetëm në fushën e interpretimit në gjykata...»<sup>1</sup>. Ky pohim i shkon për shtat më së miri kontekstit shqiptar,

1 F. PÖCHHACKER, *Dolmetschen. Konzeptuelle Grundlagen und deskriptive Untersuchungen*. 2. Auflage. Stauffenburg Verlag, Tübingen 2017, 46.

pasi objekti i ligjit nr. 82/2021 „Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar“, nuk është profesioni i interpretit në tërësi, por vetëm rregullimi i përkthimit zyrtar, si një segment i posaçëm i tregut përkthimor, pra të shërbimeve të përkthimit zyrtar dhe të interpretimit zyrtar.

Në nenin 4, pika d të ligjit në fjalë, përkthimi zyrtar përkufizohet si përkthimi me shkrim i dokumenteve zyrtare, i akteve normative shtetërore apo i marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe përkthimi me gojë gjatë procesve hetimore apo gjyqësore<sup>2</sup>. Kësisoj, çdo lloj tjetër interpretimi a përkthimi nuk përbën objekt të ligjit. Konkretisht ligji rregullon atë lloj interpretimi që në anglisht njihet me termin *legal interpreting* sikurse përkufizohet në *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*<sup>3</sup> dhe në *Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*<sup>4</sup>. Nga ana përmbajtësore, ligji shqiptar e përkufizon këtë lloj interpretimi thjesht si një formë të caktuar përkthimi. Nga ana gjuhësore, ligji e emërtën këtë veprimtari profesionale *përkthim me gojë*, ndërsa interpretin jo si të tillë, por *përkthyes me gojë*. Në ligjin në fjalë, termi *interpret* përdoret vetëm për të emërtuar interpretin në gjuhën e shenjave.

### 1.1 Pasojat e kuadrit ligjor në statusin profesional të interpretit

Për shkak të mungesës së rregullimeve të tjera ligjore në lidhje me profesionin e interpretit si të tërë, apo me lloje të tjera interpretimi, ky ligj mund të prekë edhe këto të fundit, nëse klientët zgjedhin t'i referohen këtij ligji, edhe në rastet kur aktiviteti, për të cilin kërkojnë interpretë nuk është brenda fushës së zbatimit të ligjit nr. 82/2021. Kështu për shembull, institucionet publike i referohen dispozitave të këtij ligji edhe kur kanë nevojë për interpretë konferencash, si dhe listës së përkthyesve zyrtarë, të njohur nga Ministria e Drejtësisë. Po kështu norma e honorarit mbështetet në përcaktimet e së njëjtës ministri<sup>5</sup>. Përvoja ndërkombëtare tregon se niveli i pagesave për interpretët e konferencave është më i lartë se për interpretët e bashkësisë apo interpretët në gjykata<sup>6</sup>. Në këtë kuptim, ligji ndikon drejtpërdrejt në disa prej kriterëve për statusin e profesionit, posaçërisht në «... (2) *professional monopoly over specific types of work, ...*

2 LigjiNr. 82/2021 „Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar“, 2.

3 Shih: PH. S. ANGERMEYER, *Legal interpreting*, in M. BAKER – G. SALDANHA, (eds.), *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*, 3<sup>rd</sup> edition, Routledge, London – New York 2020, 275-280.

4 Shih: E. HERTOGE, *Legal Interpreting*, in F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London - New York 2015, 230-235.

5 Urdhri nr. 192 i datës 04.05.2022.

6 E. TISELIUS, *Conference and community interpreting: Commonalities and differences*, in M. ALBL-MIKASA – E. TISELIUS (eds.), *The Routledge Handbook of Conference Interpreting*. Routledge, London – New York, 2022, 56.

(8) remuneration reflecting professional standing »<sup>7</sup>.

Shqyrtimi i ligjit të lartpërmendur tregon se hartimi dhe miratimi i tij mbështetet në tri premisa:

Së pari: profesioni i interpretit nuk ka dallim nga profesioni i përkthyesit.

Sikurse jemi shprehur më lart, kjo premisë lexohet qartë në mënyrën sesi ligji përkufizon profesionin e përkthyesit zyrtar. Për rrjedhojë, përkthyesit e përfshirë në listën zyrtare mund të punojnë qoftë si përkthyes, qoftë si interpretë, duke iu nënshtruar të njëjtës procedurë testimi si për njërën veprimtari profesionale, ashtu dhe për tjetrën. Pa dashur të thellojmë diskutimin teorik për këtë çështje, po sjellim shembullin e institucioneve ndërkombëtare, si p.sh. Bashkimi Evropian, ku procedurat e testimit për punësimin apo akreditimin e interpretëve dhe të përkthyesve janë krejtësisht të ndara e të ndryshme nga njëra-tjetra<sup>8</sup>.

Së dyti: çdo individ i aftë të kryejë përkthime, është i aftë të bëjë interpretim.

Identifikimi i kësaj premise bazohet në shqyrtimin e dispozitave ligjore për procedurën e testimit, veçanërisht në peshën e pabarabartë që i jepet testimit me shkrim krahasuar me atë me gojë (70 pikë përkundrejt 30 pikëve)<sup>9</sup>. Përpos kësaj, kalimi i testimit me shkrim përbën kusht për pranimin në testimin me gojë.

Rrjedhimisht, ligji mbart pasoja jo vetëm për statusin profesional të interpretit, por dhe për cilësinë e shërbimeve të ofruara, pasi ai nuk rrok thelbin që dallon interpretin nga përkthyesi, sa i takon çështjeve thelbësore sikurse janë aftësitë dhe shprehitë e dallueshme të përkthyesve dhe të interpretëve, proceset konjitive krejt të ndryshme për përmbushjen e këtyre dy veprimtarive si dhe strategjitë dhe teknikat e dallueshme që përdoren në përkthim dhe në interpretim<sup>10</sup>.

Së treti: kompetenca gjuhësore nuk dallon nga kompetenca përkthimore.

Kjo premisë lexohet qartë në dispozitat ligjore për përcaktimin e

7 I. WEISS-GAL – P. WELBOURNE, *The professionalization of social work: a cross-national exploration*, "International Journal of Social Welfare" (2008), 17, 283 – 288. Shih dhe: H. DAM, *Status*, in F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*. Routledge, London – New York 2015, 400.

8 DG-Translation: [https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/translation\\_en#responsibilities](https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/translation_en#responsibilities) (17.06.2024)  
DG-SCIC: [https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/interpretation\\_en](https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/interpretation_en) (17.06.2024)

9 Verordnung Nr. 192 vom 04.05.2022, 7.

10 Për një vështrim të thelluar të ligjit shqiptar nr. 82/2021 shih: I. THEMELI, *Reflections on the legal status of the term "interpreter" and the professional status of interpreting in Albania*, in A. KARDAŞLAR – M. KIDIRYUZ (eds.), *Atlas, 12<sup>th</sup> International congress of advanced scientific studies and interdisciplinary research, Conference proceedings*, Paris 2024, 485-497.

përmbajtjes së testimit, synimi i të cilit është testimi i njohurive të gjuhës së huaj. Këndvështrimi se kompetenca gjuhësore mjafton për të interpretuar, është «*freilich<sup>11</sup> aus der Sicht des professionellen Dolmetscherwesens und der universitäten Ausbildungsinstitute eine unhaltbare Annahme. In Praxis und Wissenschaft besteht weitestgehend Konsens darin, dass Zwei- oder Mehrsprachigkeit... zwar eine notwendige, nicht aber eine hinreichende Bedingung für die Befähigung zur (beruflichen) Ausübung des Dolmetschens darstellt*»<sup>12</sup>. Në dallim nga kompetenca gjuhësore, kompetenca përkthimore është më e gjerë. Ajo mbështetet në kompetencën gjuësore dhe kulturore, por «*schließt<sup>13</sup> vor allem auch den kognitiven und sprachlichen Umgang mit dem jeweiligen Wissensgebiet, Sachbereich oder Gegenstand der Kommunikation mitein*»<sup>14</sup>.

Shtjellimet e mësipërme të çojnë në përfundimin se kuadri ligjor nuk arrin të përmbushë synimin e vet për të garantuar cilësinë e shërbimeve të përkthimit dhe të interepretimit. Veç kësaj, fryma e ligjit nuk jep impulse pozitive as për statusin e profesionit të interpretit juridik në veçanti, dhe as për profesionin e interpretit në përgjithësi në Shqipëri.

## 1.2 Rëndësia e artikullit / e trajtesës

Kuadri ligjor pasqyron pikëpamjet e ngulitura në një shoqëri të caktuar duke i pranuar sikundër janë, apo duke kontribuar për emancipimin e tyre.

Në mendimin tonë, problemi i cekur më lart buron në sajë të ndërveprimit të dy faktorëve: së pari të mosnjohjes së interpretimit dhe rrjedhimisht të mungesës së të kuptuarit të tij si një veprimtari qartësisht të dallueshme nga përkthimi dhe së dyti në sajë të mosngulitjes gjuhësore të termit *interpret* në gjuhën shqipe. Kësisoj, është me rëndësi dhe dobi shqyrtimi i fjalëve *përkthej vs. interpretoj*, term i përdorur në rrethin e profesionistëve dhe të studiuesve të fushës, *përkthim vs. interpretim*, si dhe *përkthyes vs. interpret*, **në krye të herës në rrafshin leksikor**, duke qyrrur shpërfaqjen dhe shpjegimet gjegjëse në fjalorë të gjuhës shqipes.

Sikurse jemi shprehur në hyrje të këtij artikulli, në Shqipëri interpreti dhe interpretimi nuk ndahen preraz e qartas nga përkthyesi dhe përkthimi

---

11 Përkthimi i autores i pasazhit në gjermanisht: është një premisë e papranueshme në këndvështrimin e interpretimit profesional dhe të institucioneve universitare për formimin e interpretëve. Si në praktikën e profesionit, ashtu dhe në teori pranohet gjerësisht se dygjuhësia apo shumëgjuhësia... përbëjnë një kusht të nevojshëm, por aspak të mjaftueshëm për ushtrimin profesional të interpretimit.

12 PÖCHHACKER, 2017, 44.

13 Përkthimi i autores i pasazhit në gjermanisht: përfshin para së gjithash rrokjen konjitive dhe gjuhësore të lëmisë përkatëse të dijes, të fushës tematike dhe të objektit të komunikimit.

14 PÖCHHACKER, 2017, 44.

si në rrafshin shoqëror, ashtu dhe atë ligjor. Ndër të tjera, arsyet lidhen edhe me faktorë historikë, ku vlen të përmendet se interpreti dhe interpretimi<sup>15</sup> zor se nevojitesh në kushtet e izolimit të Shqipërisë gjatë diktaturës komuniste. Në ato raste të rralla, kur lindte nevoja për interpretim, ishin përkthyesit që mbulonin edhe këtë detyrë<sup>16</sup>. Kësisoj, ligji i lartpërmendur është pasqyrë e këndvështrimit të gabuar shoqëror se interpretimi nuk është veç një shtojcë e përkthimit, një veprimtari profesionale që *a priori* mund ta kryejë përkthyesi. Rrjedhimisht, ky ligj nuk i shërben as emancipimit të perceptimit publik a shoqëror, dhe as mëvetësisë të profesionit të interpretit.

Ky fakt rëndon edhe më shumë po të kemi parasysh, se në Shqipëri - pavarësisht disa përpjekjeve - ende mungon një shoqatë e interpretëve, e cila sikurse ka ndodhur në vende të tjera, ka qenë një faktor vendimtar për kristalizimin e profesionit, përcaktimin e standarteve profesionale dhe të normave deontologjike, por edhe në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interpretëve në marrëdhënie me palët e tjera<sup>17</sup>.

Thënë kjo, në kontekstin shqiptar janë vetë interpretët si ushtrues të profesionit dhe ata që Gile i quan *practisearchers*<sup>18</sup>, interpretë të interesuar për hulumtimin e interpretimit, grupet që mund të kontribuojnë për ndërgjegjësimin shoqëror dhe për lëvrimin e termave të mëvetësishëm *interpret* dhe *interpretim* në gjuhën shqipe.

Ndaj ky artikull, krahas rrafshit leksikor, shqyrton përdorimin e këtyre termave edhe **në rrafshin e ligjërimit të studiuesve të përkthimologjisë**<sup>19</sup> në Shqipëri.

Në vijim të parashtrimeve të deritanishme, artikulli merr shkas nga dy çështje që shtron Pöchhacker sa i takon «*dallimit ndërmjet përkthimit dhe interpretimit në fjalorë, shkrime akademike...*» dhe «*dallimit semantiko-leksikor në gjuhë të tjera ndërmjet 'interpreting'dhe 'interpretation' në kuptimin e aktivitetit përkthimor dhe në kuptimin hermeneutik, shpjegues?*»<sup>20</sup>

Rëndon për të dalluar interpretin nga përkthyesi, në shqip përdoret togfjalëshi *përkthyes me gojë*, interpretimi quhet po aq rëndom *përkthim*

15 Shih: M. KUMBARO, *Interpretimi, një profesion, një teori dhe një perspektivë pedagogjike për shkollën shqiptare të përkthimit*, Punim i pabotuar doktrate, Tiranë 2009, 13-14.

16 M. KUMBARO, 2009,13-14.

17 Shih: CH. THIÉRY, AIC, in F. PÖCHHACKER (eds.), *Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York, 13-15.

18 D. GILE, *Opening up in Interpreting Studies*, in M. SNELL-HORNBY – F. PÖCHHACKER – K. KAINDL (eds.), *Translation Studies. An Interdiscipline*, John Benjamins Publishing, Amsterdam – Philadelphia 1994, 150.

19 Për emërtimin e disiplinës së përkthimologjisë në shqip shih: M. KUMBARO, 2009, xvi dhe E. TUPJA, *Këshilla një përkthyesi të ri*, botimi i tretë, Onufri, Tiranë 2007,15.

20 F. PÖCHHACKER, *Introducing Interpreting Studies*, Third Edition, Routledge, London – New York 2, 27.

me gojë. Modaliteti i realizimit gjuhësor, pra shprehja e kumtit me anë të gjuhës së folur apo të shkruar, ka shërbyer për shumë kohë për dallimin ndërmjet këtyre dy veprimtarive përkthimore<sup>21</sup>, por në rrethet e studiuësve të disiplinës konsiderohet tashmë i vjetëruar dhe i pamjaftueshëm për të përshkruar dallimin e qenësishëm të interpretimit nga përkthimi.

Në thelb të dallimit qëndron karakteri i menjëhershëm (imediati) i interpretimit. Kështu në *Interpreting Studies Reader*, Pöchhacker e përkufizon interpretimin si «... *a form of Translation*<sup>22</sup> in which a **first and final rendition in another language**<sup>23</sup> is produced on the basis of a **one-time presentation** of an utterance in a source language.»<sup>24</sup>.

Kriteret, mbi të cilat mbështetet ky përkufizim bazohen në përkufizimin e Otto Kade-s<sup>25</sup>, i cili nxjerr në pah karakteristikat në vijim:

- Teksti burimor paraqitet vetëm një herë, rrjedhimisht ai nuk mund të përsëritet e as nuk mund të rishihet.
- Teksti mbërritës realizohet nën presionin e kohës, pa shumë mundësi për t'u riparë apo për t'u korrigjuar.

Në këto përkufizime, modaliteti i realizimit të kumtit me anë të gjuhës së folur nuk shërben si *definiens*. Kësisoj ato i hapin udhë përfshirjes së llojeve të ndryshme të interpretimit në një përkufizim të vetëm, përfshirë p.sh. interpretimin në dhe nga gjuha e shenjave apo interpretimin me letër.

Duke u mbështetur në këto përkufizime të interpretimit, ky artikull shqyrton fjalët e shqipes *përkthej vs. interpretoj, përkthim vs. interpretim* sowie *përkthyes vs. interpret*.

## 2. Rrafshi leksikor

### 2.1 Ausgewählte Wörterbücher

Në vijim do të shqyrtohet në këndvështrimin semantiko-leksikor paraqitja dhe shpjegimi i fjalëve *përkthej, përkthim* dhe *përkthyes vs. interpretoj, interpretim* bzw. *interpret* në fjalorë të ndryshëm të gjuhës shqipe.

21 C. B. ROY, *The problem with definitions, descriptions and the role of metaphors of interpreters*, in F. PÖCHHACKER – M. SCHLESSINGER (eds.), *The Interpreting Studies Reader*. Routledge, London - New York 2002, 346-353.

22 Shënim: Pöchhacker përdor qëllimisht shkrimin me gërmë të madhe të fjalës 'Translation' në anglisht, për ta dalluar këtë si term të epërm që përfshin *translation* dhe *interpreting* zu verweisen. Shih: F. PÖCHHACKER, *Introducing Interpreting Studies*, Third Edition, Routledge, London – New York 2022, 9.

23 Shënim: Shkrimi i theksuar në origjinal.

24 F. PÖCHHACKER, 2022, 11.

25 O. KADE, *Zufall und Gesetzmäßigkeit in der Übersetzung*, VEB Verlag Enzyklopädie, Leipzig 1968, 35.

Në kuptimin e disiplinës së përkthimologjisë, përkthimi dhe interpretimi janë akte përkthimore<sup>26</sup>, pra akte të kalimit të një teksti (në kuptimin metagjuhësor) nga njëra gjuhë në tjetrën. Për këtë qëllim do të kqyren *Fjalori i gjuhës shqipe* i vitit 1954<sup>27</sup>, *Fjalori i shqipes së sotme* në botimin e vitit 1984<sup>28</sup> dhe 2002<sup>29</sup>, *Fjalori i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe*<sup>30</sup> si dhe *Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe*<sup>31</sup>.

Sa i takon përzgjedhjes së fjalorit të shqipes (1954, 1984, 2002), vëmë në dukje se bëhet fjalë për fjalorin më të madh të gjuhës shqipe dhe një vepër standard reference. Fjalorët e tjerë janë përfshirë për hir të faktit se fjalët *interpret*, *interpretoj* dhe *interpretim* janë huazime apo fjalë të prejardhura prej tyre.

## 2.2 Folja *përkthej* vs. *interpretoj*

*Fjalori i Gjuhës Shqipe* i vitit 1954 e shpjegon foljen *përkthej*<sup>32</sup> si në vijim: e kthej nga një gjuhë në një gjuhë tjetër. Ndryshe nga fjalorët e mëvonshëm, këtu folja nuk shpjegohet duke shtuar përbërësit semantikë *,me shkrim'* apo *,me gojë'* as në lidhje me tekstin a ligjëratën burimore dhe as atë mbërritëse, por thjesht duke vënë dukje procesin e kalimit nga njëra gjuhë në tjetrën.

Të dyja botimet e *Fjalorit të shqipes së sotme*, e shpjegojnë kuptimin e parë të foljes *përkthej*<sup>33</sup> si në vijim: 1. Kthej diçka të folur a të shkruar nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, duke ruajtur tërësisht kuptimin e fjalëve e përmbajtjen. Ai jep shembujt: *Përktheu një roman. E përktheu nga anglishtja. Përkthej me shkrim (me gojë).*

Vetë folja *përkthej* në shqip është fjalë e prejardhur nga folja *kthej*<sup>34</sup>, e cila në shqip sipas *Fjalorit të shqipes së sotme* ka 14 kuptime të ndryshme. Njëri prej tyre renditet nga fjalori si sinonim i foljes *përkthej* në regjistrin bisedor dhe shpjegohet kështu: 10. *bised*. Përkthej; sjell në një gjuhë më të kuptueshme. *E ktheu shqip. E ktheu në gjuhën e sotme*<sup>35</sup>.

26 F. PÖCHHACKER, 2022, 9.

27 K. CIPO – E. ÇABEJ – M. DOMI, A. KRAJNI, A. MYDERRIZI, *Fjalori i gjuhës shqipe* 1954. Instituti i Shkencave, - Neuaufage Çabej, Tiranë 2005.

28 Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 1984.

29 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalori i shqipes së sotme*, Botimi i dytë, Tiranë 2002.

30 M. NDRECA, *Fjalori fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*. Toena, Tiranë 2007.

31 T. DIZDARI, *Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe*. o.V., Tiranë o.J.

32 K. Cipo et.al, 1954, 399.

33 Akademia e Shkencave, 1984, 901, 2002, 979.

34 Akademia e Shkencave, 2002, 563.

35 Ibid.

Tupja hamendëson se deri në fillim të shekullit XX në shqip është përdorur folja *kthej* (kthej nga një gjuhë në tjetrën), ndërsa folja *përkthej* është më e vonë<sup>36</sup>.

Nga pikëpamja e fjalëformimit parashtesa *për* në shqip është një parashtesë prodhimtare, e cila « *ndryshon kuptimin e temës fjalëmormuese duke i dhënë një kuptim më intensiv ose duke i dhënë jo vetëm kuptim më intensiv, por dhe ngjyrim të reja kuptimore*»<sup>37</sup>. Folja *përkthej* i takon rastit të dytë<sup>38</sup>.

Ndërsa foljen *interpretoj*<sup>39</sup> Fjalorët e shqipes së sotme e shpjegojnë kështu: 1. Shpjegoj a shkoqit diçka të errët e të vështirë për të tjerët; e paraqit a e sqaroj diçka ashtu si e kuptoj ose si e mendoj unë. *Interpreton ligjet. E interpretoi drejt (keq, ndryshe)*. 2. Shpreh mendimet, ndjenjat, dëshirat a kërkesat e një tjetri, bëhem zëdhënës i një tjetri. 3. Luaj një rol në një dramë ose luaj një pjesë muzikore; këndoj një këngë a luaj një valle në një shfaqje. *E interpretoi me mjeshtëri*.

Të tre fjalorët e gjuhës shqipe i njohin foljes *interpretoj* pikësëpari kuptimin hermeneutik që ndeshet edhe në gjuhë të tjera p.sh. *interpretare* në italisht<sup>40</sup> apo *to interpret* në anglisht<sup>41</sup>. Por ndryshe nga sa ndodh në anglisht, folja shqip *interpretoj* nuk shpjegohet shprehimisht si veprimtari përkthimore.

Shpjegimet e dhëna në *Fjalorin e shqipes së sotme* në botimin e parë (1984), janë ruajtur kryekëput edhe në botimin e dytë (2002). Ato nxjerrin në pah qartë se kuptimi i qenësishëm semantik i veprimtarisë përkthimore (kalimit nga një gjuhë në tjetrën) i njihet vetëm foljes *përkthej*, e cila bazuar në këtë përkufizim do të kishte dy gjegjëse në disa gjuhë të tjera, konkretisht në gjermanisht *übersetzen* dhe *dolmetschen*, në anglisht *to translate* dhe *to interpret*. Ndërsa në foljet e këtyre gjuhëve, përbërësi semantik i mënyrës së realizimit të veprimit (gjuhë e folur a gjuhë e shkruar) apo i natyrës së lëndës burimore (tekst a ligjërim) ngërthehet brenda kuptimit denotativ të fjalës, në shqip për të shprehur mënyrën e realizimit nevojitet zgjerimi në togfjalëshin *përkthej me shkrim apo me gojë*.

### 2.3 Emri *përkthim* vs. *interpretim*

Kuptimi semantiko-leksikor i foljes *përkthej* shërben si pikënisje për shpjegimin e fjalëve *përkthim* dhe *përkthyes*, duke qenë se tema

36 E. TUPJA, 2007, 61.

37 Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gramatika e Gjuhës Shqipe I, Tiranë 1995, 349.

38 Ibid.

39 Akademia e Shkencave, 1984, 456 dhe 2002, 511.

40 [https://www.treccani.it/vocabolario/interpretare\\_\(Sinonimi-e-Contrari\)/](https://www.treccani.it/vocabolario/interpretare_(Sinonimi-e-Contrari)/) (aksesuar më 01.07.2024)

41 <https://www.merriam-webster.com/dictionary/interpret> (01.07.2024).

fjalëformuese e të dyjave është folja *përkthej*. Sipas *Fjalorit të shqipes së sotme*, kuptimi i parë i fjalës *përkthim* në shqip është veprimi sipas foljes *përkthej*, *përkthehet*, ndërsa kuptimi i dytë lidhet me produktin<sup>42</sup>. Pra në shqip *përkthim* përcakton si procesin, ashtu dhe produktin, sikurse ndodh edhe në gjuhë të tjera p.sh. në frëngjisht *traduction*<sup>43</sup>, në spanjisht *traducción*<sup>44</sup>, në anglisht *translation*<sup>45</sup> dhe në gjermanisht *Übersetzung*<sup>46</sup>.

Në *Fjalorin e terminologjisë së përkthimit* të Delisle, Lee-Jahnke dhe Cormier, hartuar në të katra gjuhët e renditura më lart për efekt krahasimi, përkufizimi i përkthimit si proces plotësohet duke shënuar dallimin e tij nga interpretimi. Përkatësisht ky emërtohet në frëngjisht *interprétation*<sup>47</sup>, në spanjisht *interpretación*<sup>48</sup>, në anglisht *interpreting*<sup>49</sup> dhe në gjermanisht *Dolmetschen*<sup>50</sup>.

Vlen të vihet në dukje se *interprétation* në frëngjisht dhe *interpretación* në spanjisht shpjegohen si në kuptimin e parë, si operacion përkthimi i zbrëthimit të kuptimit të tekstit, pra duke iu afruar kuptimit hermeneutik të fjalës, ashtu dhe si veprimtari përkthimore me gojë ose në gjuhën e shenjave. Ndryshe ndodh në anglisht dhe në gjermanisht, ku dallimi semantik ndërmjet kuptimit hermeneutik dhe aktit përkthimor shprehet me dy njësi të dallueshme leksikore përkatësisht *interpretation*<sup>51</sup> vs. *interpreting*<sup>52</sup> në anglisht dhe *Interpretation*<sup>53</sup> vs. *Dolmetschen*<sup>54</sup> në gjermanisht.

Në shqip, duke ndjekur logjikën leksikore të fjalorit, mund të thuhet se emri *përkthim* në kuptimin e procesit i shpjeguar si veprimi sipas foljes *përkthej*, shërben si për të emërtuar *translation* ashtu dhe *interpreting*. Kuptimin e fjalës si produkt të procesit të përkthimit, *Fjalori i shqipes së sotme* e shpjegon si: tekst a vepër që është përkthyer në një gjuhë tjetër. *Përkthim besnik (i lirë). Përkthimet e F. Nolit. Merret me përkthime*<sup>55</sup>. Në

42 Akademia e Shkencave, *Fjalori i shqipes së sotme*, 2002, 979.

43 J. DELISLE - H. LEE-JAHNKE - M.C. CORMIER, (eds.), *Terminologie de la traduction. Translation terminology. Terminología de la traducción. Terminologie der Übersetzung*, John Benjamins Publishing, Amsterdam – Philadelphia 1999, 83.

44 Ibid., 295.

45 Ibid., 188.

46 Ibid., 402.

47 Ibid., 46.

48 Ibid., 252.

49 Ibid., 149.

50 Ibid., 350.

51 J. DELISLE - H. LEE-JAHNKE - M.C. CORMIER, 1999, 148.

52 Ibid., 149.

53 Ibid., 363.

54 Ibid., 350.

55 Akademia e Shkencave, *Fjalori i shqipes së sotme*, 2002, 979.

rastin e produktit mund të pohojmë se fjalori qartësisht e kufizon kuptimin vetëm si *translation* dhe kurrësi si *interpreting*, qoftë në bazë të zgjedhjes që bën në shpjegim për atë çka përkthehet, pra vepër që është e shkruar dhe jo ligjëratë të folur, apo tekst që në fjalor zor se përdoret në kuptimin metagjuhësor, por si lëndë e shkruar. Po kështu, referenca e shembujve të dhënë lidhet dukshëm me përkthimin dhe jo me interpretimin.

Kështu arrihet në përfundimin se në shqip referenca prototipike jashtëgjuhësore e fjalës *përkthim* është përkthimi me shkrim dhe jo interpretimi.

Kur vjen puna tek fjala *interpretim*, fjalori e shpjegon kuptimin e parë si «*veprimi sipas foljes interpretoj, interpretohet*»<sup>56</sup>, pra procesi i shpjegimit a i shkoqitjes së diçkaje të errët. Kuptimi i dytë shpjegohet si mënyra e shpjegimit a sqarimit apo mendimi i dikujt, ndërsa i fundit si mënyra e luajtjes së një roli (në veprimtarinë artistike). Asnjë prej shpjegimeve dhe as shembujt përkatës nuk lidhen drejtpërdrejt me kuptimin përkthimor.

## 2.4 Emri *përkthyes* vs. *interpret*

Sa i takon emrit *përkthyes*, ai shpjegohet si «*ai që përkthen; ai që merret me përkthime*»<sup>57</sup>. Pra duke u bazuar në kuptimin e foljes *përkthej*, sipas pjesës së parë të shpjegimit mund të themi se është ai që përkthen me shkrim apo me gojë, ndërsa po t'i referohemi pjesës së dytë të shpjegimit sipas fjalorit përsa kemi shtjelluar më lart, kuptimi i *agens* lidhet vetëm me përkthimin me shkrim dhe jo me gojë.

Emri *interpretues* formohet nga folja *interpretoj*. Fjalori i shqipes së sotme e shpjegon kuptimin e fjalës *interpretues* si «*ai që interpreton diçka*»<sup>58</sup>, pra ai që shpjegon a shkoqit diçka të errët; ai që shpreh mendimet, ndjenjat a kërkesat e një tjetri, që bëhet zëdhënës i tij. Një prej shembujve që rendit fjalori është pikërisht togjalëshi *interpretues zyrtar*, kuptimi i të cilit mbetet i paqartë po të ndjekësh rrjedhën e shpjegimit leksikor të fjalorit duke u nisur nga folja *interpretoj*. Një indicie se emri *interpretues* emërton interpretin (*Dolmetscher, interpreter*) gjendet në Fjalorin shqip-gjermanisht të Dhrimos, i cili si gjegjëse të tretë të fjalës shqipe rendit në gjermanisht fjalën *Dolmetscher*<sup>59</sup>.

Ndryshe nga *interpretues*, fjala *interpret* nuk renditet në asnjë prej *Fjalorëve të shqipes së sotme*. Mendojmë se kjo shërben për të shpjeguar se përse ligji nr. 81/2021 *‘Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar’*, për përkufizimin e interpretit të gjuhës së shenjave i përdor të dy

56 Ibid., 511.

57 Akademia e Shkencave, *Fjalor i shqipes së sotme*, 2002, 979.

58 Ibid., 511.

59 A. DHRIMO, *Albanisch-Deutsches Wörterbuch*, Infbotues, Tiranë 2005, 453.

termat në mënyrë sinonimike. Por me përjashtim të përkufizimit, ligji përdor në vazhdim vetëm fjalën *interpret*, kurdo që i referohet interpretit të gjuhës së shenjave.

Emri *interpret* shfaqet si zë leksikor në *Fjalorin e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe*, ku shpjegohet si « *përkthyes; ai që është ngarkuar të flasë në emrin e tjetrit, shprehës*»<sup>60</sup> në dallim nga fjala *interpretues* e shpjeguar si «*ai që interpreton diçka*»<sup>61</sup> në vijim të kuptimeve të foljes *interpretoj*, tri kuptimet e së cilës në fjalorin e Ndrecës përputhen me shpjegimet në *Fjalorin e shqipes së sotme* (1984, 2002). Në vijim të rrjedhës sqaruese të fjalorit mund të themi se shpjegimi i fjalës *interpret* në fjalorin e Ndrecës lidhet me kuptimin e dytë të foljes *interpretoj*: flas në emër të një tjetri.

Fjala *interpret* shfaqet edhe në *Fjalorin e orientalizmeve në gjuhën shqipe* si shpjegim i fjalës *terxhymén*<sup>62</sup>, krahas fjalës *përkëthyes*. Autori rendit edhe gjegjëset në gjermanisht *Dolmetsch*, dhe në italisht *traduttore, dragomanno*<sup>63</sup>.

Përmbledhtazi mund të thuhet se në rrafshin leksikor fjalët *interpretoj* *interpretim* dhe *interpretues* nuk i referohen drejtpërdrejt aktit përkthimor. Fjala *interpret* shfaqet vetëm në fjalorët e fjalëve të huaja, por në asnjë prej fjalorëve të gjuhës shqipe. Fjalët *përkthej*, *përkthim* und *përkthyes* kanë si referencë të parë kuptimore përkthimin me shkrim, ndërsa tipari semantik i mënyrës së realizimit *me gojë* në kuptimin e interpretimit si akt përkthimor është dytësor. Për shkak të këtij kushtëzimi leksikor, mendojmë se ligji shqiptar përdor togun *përkthyes me gojë* për të emërtuar interpretin e gjuhës së folur në dallim nga përdorimi në rastin *interpret i gjuhës së shenjave*.

Në këndvështrimin tonë, kjo ndodh sepse ligjëvënësi e konsideron gjuhën e shenjave, një sistem semiotik krejt të ndryshëm nga sistemi i shenjave gjuhësore në kuptimin sosyrian dhe që mbështetet në përdorimin e shenjave jogjuhësore si një lëndë me karakter më pak të kuptueshëm, pra të errët që ka nevojë për interpretim apo “meriton” interpretim në kuptimin hermeneutik të fjalës.

Një tjetër arsye mendojmë se lidhet me faktin që emërtimi në shqip *interpret i gjuhës së shenjave* përbën një kalk gjuhësor nga emërtimi në anglisht *signed language interpreter*, i cili nuk lë shteg për ta përfshirë këtë lloj përkthimi brenda kuptimit të përgjithshëm *përkthim*, referenca propotipike jashtëgjuhësore e të cilit në shqip është përkthimi me shkrim dhe interpretimi i gjuhëve të folura.

60 M. NDRECA, *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*. Toena, Tiranë 2007, 281.

61 Ibid.

62 T. DIZDARI, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*. s.n.Tiranë s.a., 1026.

63 Ibid.

### 3. Rrafshi i ligjërimit të studiuesve të përkthimologjisë

Në vijim do të shqyrtohet shpërfaqja dhe përdorimi i fjalëve *përkthej*, *përkthim*, *përkthyes* dhe *interpret*, *interpretim*, *interpret* në rrafshin e ligjërimit të studiuesve të përkthimologjisë në Shqipëri.

Në krye të herës vlen të përmendet se fjalët *interpretim* dhe *interpret* përdoren shprehimisht si në programet e studimit për formimin e përkthyesve dhe interpretëve, ashtu dhe në emërtimet përkatëse të diplomës<sup>64</sup>. Programet mësimore për lëndët e interpretimit janë në gjuhët e huaja përkatëse, çka nuk i ndih lëvrimit të termave të interpretimit në shqip apo standartizimit metagjuhësor. Përpjekje të kësaj natyre në radhët e studiuesve të fushës janë të pakta, madje duhet thënë se në kontekstin shqiptar mund të flasim vetëm për profesionistë të interpretimit me interes për studimin e tij që Gile i quan *practisearchers*<sup>65</sup>.

Kjo rrethanë përbën faktorin përcaktues për përzgjedhjen e dy shkrimeve / veprave që janë shqyrtuar.

Për të plotësuar tablonë e shtjellimeve të deritanishme do të përqendrohemi në mënyrën sesi përdoren termat *interpret*, *interpretim* dhe *interpret* në dy botime në gjuhën shqipe, konkretisht në veprën e Kumbaros *Metodologji dhe didaktikë e përkthimit me gojë* dhe të Tupjes *Këshilla një përkthyesi të ri*.

Sa i takon titullit të dytë duhet të vërejmë që në fillim, se teksti në trajtimet e veta teorike, ka më shumë natyrë informuese, ndërgjegjësuëse e karakter divulgativ, sesa është një trajtesë thellësisht shkencore pasi i drejtohet kryesisht publikut të interesuar për fushën e përkthimit dhe të interpretimit.

Ndërsa titulli i parë është tekst universitar me karakter studimor aplikativ që synon të paraqesë një model didaktik për formimin e interpretëve, «*përpunimin e terminologjisë së re të fushës ... dhe sjelljen e një metagjuhe të interpretimit*»<sup>66</sup>.

Në parathënien e librit të saj, Kumbaro shprehet për nevojën e një modeli pedagogjik për formimin e interpretëve, ndër të tjera edhe «*për të luftuar paragjykimet diletante se kushdo që di një gjuhë mund të quhet automatikisht interpret konference*»<sup>67</sup>, një shqetësim i drejtë që e ndan edhe Tupja<sup>68</sup>.

64 Në varësi të gjuhës B, emërtimi i plotë është p.sh. Përkthyes dhe interpret i gjuhës gjermane.

65 D. GILE, 1994, 150.

66 M. KUMBARO, Metodikë dhe didaktikë e përkthimit me gojë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2010, 9.

67 Ibid., 8.

68 E. TUPJA, 92.

Në vijim paraqitet përdorimi i fjalëve *interpret vs. përkthyes, interpretim vs. përkthim* dhe *interpretoj vs. përkthej* nga këta dy autorë.

### 3.1 Përdorimi në librin „Metodologji dhe didaktikë e përkthimit me gojë“

Sikurse shprehet Kumbaro në hyrje të librit, teksti është konceptuar si tekst universitar<sup>69</sup>. Kësisoj i drejtohet kryesisht mësimdhënësve dhe studentëve të interpretimit, megjithatë autorja në titull të librit për të emërtuar interpretimin zgjedh të përdorë togfjalëshin *përkthim me gojë*. Në brendi të tekstit, në kreun e parë *Përkthimi dhe interpretimi – “dy miq armiq”*, para se të ravigëzojë si të përbashkëtat, ashtu dhe dallimet ndërmjet këtyre dy veprimtarive, autorja vendos të qartësojë përdorimin në tekst duke shtuar përkatësisht në kllapa sqarimin *përkthim me shkrim* për përkthimin dhe *përkthim me gojë* për interpretimin<sup>70</sup>.

Mendojmë se duke qenë e vetëdijshme për mungesën e ngulitjes kuptimore të fjalës *interpretim* si akt përkthimor në gjuhën shqipe, Kumbaro ndjen të nevojshme të bëjë këtë shpjegim për të përcaktuar kodin e leximit të tekstit, por edhe për të ngulitur në vend të *përkthim me gojë* fjalën *interpretim* si *terminus technicus*, i cili më pas përdoret sistematikisht në brendi të tekstit.

Termi *interpretim* përdoret në mënyrë rigoroze për të paraqitur llojet e interpretimit, madje edhe për *sight translation*<sup>71</sup> që Kumbaro e sjell në shqip si *interpretim me letër*<sup>72</sup>, ndryshe nga Tupja që përdor në shqip *përkthim me të parë*<sup>73</sup>. Varianti i përdorur nga Tupja duhet parë si një kalk gjuhësor sipas termit në frëngjisht *traduction à vue*.

Në brendi të tekstit, Kumbaro e përdor termin *interpretim* për t’iu referuar si procesit si akt përkthimor dhe operacioneve që ai ndërthet, ndër të tjera teksta shpjegon Teorinë Interpretative të Seleskovitch-it, ashtu dhe për t’iu referuar produktit, sidomos në kreun *Didaktikë interpretimi*. Sa i takon emërtimit të profesioneve, Kumbaro përdor qartë dhe të ndarë në mënyrë rigoroze termat *interpret* dhe *përkthyes*, në përputhje me frymën e

69 M. KUMBARO, 2010, 8.

70 Ibid., 17.

71 Shënim i autores: Në anglisht për këtë lloj interpretimi përdoren dy emërtime „sight translation” dhe “sight interpreting” (shih edhe Pöchhacker, 2022). Edhe në gjermanisht përdoren dy emërtime “Stegreifübersetzen” dhe “Vom-Blatt-Dolmetschen” (shih: Pöchhacker, 2017). Historikisht emërtimi „përkthim” i këtij lloji është më i hershëm, por autorë bashkëkohorë e klasifikojnë qartësisht si lloj interpretimi, për shkak të tipareve të tekstit burimor dhe atij mbërritës në përputhje me karakteristikat e përcaktuara nga Kade (1968).

72 M. KUMBARO, 2010, 49.

73 E. TUPJA, 21.

identitetit të dallueshëm profesional të njërit nga tjetri.

Në një rast, ajo përdor termin *përkthyes-interpret*<sup>74</sup> për të shprehur faktin se herë-herë ushtruesit e këtyre dy veprimtarive të dallueshme, ushtrojnë si përkthimin, ashtu dhe interpretimin. Ky përdorim mund të shihet në vazhden e nevojës për t'i dhënë vendin që i takon profesionit të interpretit edhe në pikëpamje denotative, pa e nënkuptuar brenda termit *përkthyes*. Në lidhje me foljet *interpretoj* dhe *përkthej*, Kumbaro e përdor të parën kur flet ngushtësisht për operacionet konjitive të interpretimit, të dallueshme nga ato të përkthimit, por në vijim të tekstit këto dy folje ndërkëmbehen në mënyrë sinonomike për t'iu referuar veprimit përkthimor. Folja *përkthej* përdoret sidomos kur konteksti i ngushtë gjuhësor në kombinim me fjalën *interpret* a *ligjëratë* e bën të qartë se bëhet fjalë për interpretimin dhe jo për përkthimin.

### 3.2 Përdorimi në librin „Këshilla një përkthyesi të ri“

Në dallim nga Kumbaro, Tupja përdor togfjalëshin *përkthim me gojë* për t'iu referuar interpretimit teksa përmend lloje të ndryshme të përkthimit, të cilin e përkufizon si «*veprimtari psiko-gjuhësore e ushtruar nga dikush me gojë a me shkrim...*»<sup>75</sup>. Madje, edhe kur flet për lloje si interpretimi konsektiv apo simultan, autori përdor *përkthim konsektiv, ose në vijim*<sup>76</sup> dhe *përkthim simultan, ose i njëkohshëm*<sup>77</sup>. Termi *interpretim*<sup>78</sup> përdoret për të shpjeguar se përkthimi me gojë quhet interpretim, ama në vijim të shtjellimeve të tij, Tupja ruan emërtimin *përkthim me gojë* edhe kur konteksti gjuhësor qartësisht tregon se bëhet fjalë për interpretim si p.sh. «*Përkthimi është shumë i lashtë.... Në zanafillë duhet të ketë qenë përdorur në trajtë gojore...*»<sup>79</sup>, ose kur shpjegon etapat e procesit përkthimor të interpretit<sup>80</sup>.

Kështu në rastin e Tupes, termi *përkthim* gjen tri përdorime:

- si term gjenerik që përfshin njëherazi si përkthimin dhe interpretimin siç ishte rasti i përkufizimit më lart, apo kur shtjellohet procesi përkthimor<sup>81</sup>,
- si term që i referohet vetëm përkthimit me shkrim, p.sh. në rastin e shtjellimeve rreth përkthimeve letrare, pragmatike apo të biblës,

74 M. KUMBARO, 2010, 18.

75 E. TUPJA, 12.

76 Ibid., 20.

77 Ibid., 21.

78 Ibid., 20.

79 Ibid., 8.

80 Ibid., 35ff.

81 Ibid., 24.

- si term që i referohet vetëm interpretimit sikurse e kemi parashtruar më lart.

Termi *interpretim* nuk përdoret asnjëherë si nocion i mëvetësishëm për t'iu referuar aktit përkthimor. Kurdo që përdoret në këtë kuptim, ai shoqërohet me shpjegimin *përkthim me gojë*. Në raste të caktuara, fjala *interpretim* përdoret në kuptimin hermeneutik si pjesë e procesit përkthimor të zbërthimit të kuptimit si p.sh. «...*Françoise Wuilmart-i ... rendit gjithë ato gabime ... si për shembull, ato leksikore (gabim interpretimi, ....)*»<sup>82</sup>.

Gjithashtu ky term përdoret edhe kur autori përkthen në shqip emërtimet e fakulteteve të ndryshme evropiane si *École Supérieure d'Interprètes et de Traducteurs* në Paris bzw. *École de traduction et d'interprétation* në Gjenevë<sup>83</sup>.

Sa u takon foljeve *përkthej* dhe *interpretoj*, Tupja përdor vetëm të parën edhe atëherë kur konteksti gjuhësor e jashtëgjuhësor lidhet qartësisht me interpretimin. Një qasje e tillë vërehet edhe në përdorimin e fjalëve *përkthyes* dhe *interpret* si emërtime të profesioneve.

Autori përdor rëndom termin *përkthyes* për t'iu referuar interpretit. Termi *interpret* përdoret i mëvetësishëm vetëm në disa raste të izoluara, p.sh. kur autori flet për përvojën e tij profesionale si ushtrues i të dy profesioneve<sup>84</sup>. Në disa raste termi *interpret* shoqërohet me shpjegimin «...*pra përkthyesi me gojë*»<sup>85</sup>, ndërsa herë të tjera, Tupja përdor termin *përkthyes interpret* duke e shpjeguar sërish si përkthyes me gojë. Madje, autori përdor pikërisht këtë variant<sup>86</sup> edhe kur përkthen në shqip emërtimin e *Association Internationale des Interprètes de Conférence*.

Përmbledhtazi, mund të thuhet se Tupja e përdor togun *përkthyes interpret* për të emërtuar interpretin, kur rrethanat kontekstuale e detyrojnë të bëjë të qartë se nuk bëhet fjalë për përkthyesin me shkrim. Kësisoj ai e përdor krejt ndryshe nga Kumbaro, e cila e përdor për t'iu referuar profesionistëve që ushtrojnë si përkthimin, ashtu dhe interpretimin.

Arsyeja mund të lidhet me faktin se autori ndjen se në kontekstin shqipfolës të ligjërimit rreth përkthimit dhe interpretimit, termi *interpret* nuk është i vetëmjaftueshëm.

Në përfundim mund të thuhet se në radhët e studiuesve të fushës, termi *interpret* përdoret pa hezitim, vetëm kur komunikimi i drejtohet një publiku të specializuar e të ndërgjegjësuar për identitetin e dallueshëm

82 E. TUPJA, 65.

83 Ibid., 18.

84 Ibid., 85.

85 Ibid., 62.

86 Ibid., 91.

profesional të interpretit nga përkthyesi, por jo kur radhët e tij zgjerohen. Mungesa e ngulitjes leksikore të termit *interpret* në kuptimin kolektiv të shoqërisë, i detyron studiuesit apo edhe profesionistët që në komunikim me publikun e gjerë të përdorin termin *përkthyes*, ose ta shpjegojnë termin *interpret* si përkthim me gojë.

#### 4. Përfundime

Pas shqyrtimit të fjalëve *interpret vs. përkthyes*, *interpretoj vs. përkthej* dhe *interpretim vs. përkthim* në rrafshin leksikor dhe në rrafshin e ligjërimit të studiuesve të përkthimologjisë, për çështjen e shtruar në hyrje të këtij artikulli në lidhje me dallimin gjuhësor ndërmjet përkthimit dhe interpretimit në shqip mund të thuhet se:

Në rrafshin leksikor fjalët *interpret* dhe *interpretim* nuk përdoren as për t'iu referuar emërtimit të profesionit dhe as veprimit apo produktit përkthimor. Kuptimi i tyre përfshihet përkatësisht brenda kuptimit të fjalëve *përkthyes* dhe *përkthim*.

Në rrafshin e ligjërimit të studiuesve vërehet mungesa e konsolidimit gjuhësor dhe terminologjik. Veç kësaj, *practisearchers* ndjejnë nevojën për ta shpjeguar fjalën *interpret*, duke kontribuar kështu për ngulitjen e saj gjuhësore. Në shqip, fjala *interpretim* përdoret kryesisht në kuptimin hermeneutik. Përdorimi i fjalës në kuptimin përkthimor ndeshet vetëm në radhët e profesionistëve dhe të studiuesve të fushës. Në gjuhën shqipe nuk bëhet dallimi semantik leksikor ndërmjet *interpreting* (akt përkthimor) dhe *interpretation* (akt hermeneutik), sikurse ndodh në anglisht apo në gjermanisht. Folja *përkthej* gjen rëndom përdorim në vend të foljes *interpretoj*, madje edhe në radhët e studiuesve, kur konteksti e bën të qartë se bëhet fjalë për interpretimin.

Për sa më lart, vërejmë se lipset ende lëvrimi i mëtejshëm i termit *interpret* dhe *interpretim* në radhët e profesionistëve dhe të studiuesve, jo thjesht dhe vetëm për përdorim të ngushtë brenda lëmisë profesionale e studimore, por edhe në komunikimin me klientë dhe përdorues të interpretimit. Kështu ky lëvrim i shoqëruar me veprimtari për ndërgjegjësimin e përdoruesve dhe të ligjvënësit në lidhje me dallimet e qenësishme ndërmjet veprimtarisë profesionale të përkthimit dhe të interpretimit, mund të shërbejnë për ngulitjen leksikore dhe më tej leksikografike sipas parimeve sociolinguistike. Nga ana tjetër, është e nevojshme që termat *interpret* dhe *interpretim* të njihen e të pranohen në rrafshin shoqëror dhe ligjor, madje më përtej të bëhen pjesë e ligjërimit përkatës.

Mëvetësia terminologjike nuk përbën thjesht qëllim në vetvete. Ajo i shërben të kuptuarit e drejtë të dallimeve të qenësishme të interpretit nga përkthyesi dhe aftësive të tij krejt të dallueshme. Çka u parashtrua më lart

i shërben nxitjes së debatit dhe të reflektimit për statusin e mëvetësishëm të profesionit të interpretit në kuptimin dhe perceptimin e tij publik, jo thjesht si qëllim në vetvete, por është edhe në të mirë të ndërgjegjësimit të publikut (veçanërisht klientë dhe përdorues) në kuptimin e cilësisë së shërbimit.

## BIBLIOGRAFIA

### Burime parësore

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, botimi i dytë, Botimet, Toena, Tiranë 2002.
- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë *Fjalor i shqipes së sotme*, o.V., Tiranë 1984.
- Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, o.V, Tiranë 1995.
- A. DHRIMO, *Albanisch-Deutsches Wörterbuch*, Infbotues, Tiranë 2005
- E. TUPJA, *Këshilla një përkthyesi të ri*, botimi i tretë, Onufri, Tiranë 2007.
- K. CIPO – E. ÇABEJ – M. DOMI, A. KRAJNI, A. MYDERRIZI, *Fjalor i gjuhës shqipe 1954*, Instituti i Shkencave, - Neuauflage Çabej, Tiranë 2005.
- M. KUMBARO, *Interpretimi, një profesion, një teori dhe një perspektivë pedagogjike për shkollën shqiptare të përkthimit*, Punim i pabotuar doktorate, Tiranë 2009.
- M. KUMBARO, *Metodologji dhe didaktikë e përkthimit me gojë*, SHBLU, Tiranë 2010.
- M. NDRECA, *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë 2007.
- T. DIZDARI, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, O.V., Tiranë o.J.
- Ligji Nr. 82/2021 „Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar“ (2021). <https://qbz.gov.al/preview/1114e8fb-2c56-4e82-a2ee-2093b7367ef5/cons/20240514> (10.05.2024)
- Urdhri Nr.192 i datës 4.5.2022 “Përpërcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifave për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimit të provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën dhe mënyrën e vlerësimit të provimeve” .....  
<https://qbz.gov.al/eli/urdher/2022/05/04/192/c29ad702-1bab-40af-b577-fb3cfbc54218> (10.05.2024)

## Burime dytësore

- C. B. ROY, *The problem with definitions, descriptions and the role of metaphors of interpreters*, in F. PÖCHHACKER – M. SCHLESSINGER (eds.), *The Interpreting Studies Reader*. Routledge, London - New York 2002, 346-353.
- CH. THIÉRY, *AIIC*, in F. PÖCHHACKER (eds.), *Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York, 13-15.
- D. GILE, *Opening up in Interpreting Studies*, in M. SNELL-HORNBY – F. PÖCHHACKER – K. KAINDL (eds.), *Translation Studies. An Interdiscipline*, John Benjamins Publishing, Amsterdam – Philadelphia 1994, 149-158.
- E. HERTOOG, *Legal Interpreting*, in F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London - New York 2015, 230-235.
- E. TISELIUS, *Conference and community interpreting: Commonalities and differences*, in M. ALBL-MIKASA – E. TISELIUS (eds.), *The Routledge Handbook of Conference Interpreting*. Routledge, London – New York, 2022, 49-63.
- F. PÖCHHACKER, *Interpreting*, in F. PÖCHHACKER, *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York 2015.
- F. PÖCHHACKER, *Dolmetschen. Konzeptuelle Grundlagen und deskriptive Untersuchungen*, 2. Auflage. Stauffenburg Verlag, Tübingen 2017.
- F. PÖCHHACKER, *Introducing Interpreting Studies*. 3<sup>rd</sup> edition, Routledge, London - New York 2022, <https://doi.org/10.4324/9781003186472>.
- H.V. DAM, *Helle, Professionalization*, in F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York 2015, 400-402.
- I. THEMELI, *Reflections on the legal status of the term “interpreter” and the professional status of interpreting in Albania*, in A. KARDAŞLAR – M. KIDIRYUZ (eds.), *Atlas, 12<sup>th</sup> International congress of advanced scientific studies and interdisciplinary research, Conference proceedings*, Paris 2024, 485-497.
- I. WEISS-GAL – P. WELBOURNE, *The professionalization of social work: a cross-national exploration*, “International Journal of Social Welfare” (2008), 17, 283 – 288.
- J. DELISLE / H. LEE-JAHNKE, M.C. CORMIER, (eds), *Terminologie de la traduction. Translation terminology. Terminología de la traducción. Terminologie der Übersetzung*, John Benjamins Publishing, Amsterdam – Philadelphia 1999.
- O. KADE, *Zufall und Gesetzmäßigkeit in der Übersetzung*, VEB Verlag

Ezyklopädie, Leipzig 1968.

PH. S. ANGERMEYER, *Legal interpreting*, In: M. BAKER – G. SALDANHA, (eds.), *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*, 3<sup>rd</sup> edition, Routledge, London – New York 2020, 275-280.

### Literatur e konsultuar

- Á. COLLADO AÍS – O. GARCÍA BECERRA, *Quality*, IN H. MIKKELSEN – R. JOURDENAIS (eds.), *The Routledge Handbook of Interpreting*, Routledge, London – New York 2015, 368-383.
- F. PÖCHHACKER, *Interpreting*, IN F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York 2015, 198-200.
- J. BOÉRI, *Key internal players in the development of the interpreting profession*, IN H. MIKKELSEN – R. JOURDENAIS (eds.), *The Routledge Handbook of Interpreting*, Routledge, London – New York 2015, 29-44.
- M. BEHR, *Dolmetschen: Komplexität, Methodik, Modellierung*, Frank & Timme, Berlin 2020.
- M. RUDWIN, *Interpreting and professional identity*, IN H. MIKKELSEN – R. JOURDENAIS (eds.), *The Routledge Handbook of Interpreting*, Routledge, London – New York 2015, 432-446.
- M. PROKESCH-PREDANOVIC – K. REITHOFER-WINTER, *Arbeitsfeld Europäische Institutionen*, IN M. KADRIĆ – K. KAINDL (eds.), *Berufsziel Übersetzen und Dolmetschen: Grundlagen, Ausbildung, Arbeitsfelder*, A.Francke Verlag, Tübingen 2016, 221-232.
- N. GBRIĆ, *Profession*, IN F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York 2015, 321-326.
- N. GBRIĆ, - F. PÖCHHACKER, *Working Conditions*, IN F. PÖCHHACKER (ed.), *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, Routledge, London – New York 2015, 441-443.
- R. MERLINI, *Dialogue Interpreting*, IN M. BAKER – G. SALDANHA, (eds.), *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*, 3<sup>rd</sup> edition, Routledge, London – New York 2020, 147-152.
- R. TIPTON, *Community Interpreting*, IN M. BAKER – G. SALDANHA, (eds.), *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*, 3<sup>rd</sup> edition, Routledge, London – New York 2020, 79-84.
- W. KUTZ, *Dolmetschkompetenz: Was muss der Dolmetscher wissen und können?*. Band I und II, Europäischer Universitätsverlag, München, 2010.

## **Burime nga interneti**

DG-Translation: [https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/translation\\_en#responsibilities](https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/translation_en#responsibilities) (17.06.2024)

DG-SCIC: [https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/interpretation\\_en](https://commission.europa.eu/about-european-commission/departments-and-executive-agencies/interpretation_en) (17.06.2024)

[https://www.treccani.it/vocabolario/interpretare\\_\(Sinonimi-e-Contrari\)/](https://www.treccani.it/vocabolario/interpretare_(Sinonimi-e-Contrari)/) (01.07.2024)

<https://www.merriam-webster.com/dictionary/interpret> (01.07.2024)